


GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm- Divizioni Civil, me gjyqtarin Misin Frangu dhe zyrtaren ligjore Arbelinda Tahiri, në çështjen juridike të inicuar me padinë e paditëses NLB Banka sh.a. me seli në Prishtinë, Rr. "Ukshin Hoti" nr.149, kundër të paditurit [REDACTED] nga fsh. [REDACTED] K. Ferizaj, për shkak të kthimit të kredisë, me datë 25.01.2018, jashtë seancës gjyqësore, marrë këtë:



AKT GJYKIM

- për shkak të padëgjueshmërisë / mosbindjes -

- I. APROVOHET** në tërësi padia dhe kërkesëpadia e paditëses NLB Banka sh.a. me seli në Prishtinë dhe **OBLIGOHET** i padituri [REDACTED] nga fsh. [REDACTED] K. Ferizaj që në emër të kthimit të kredisë, t'ia paguajë paditëses shumën e mbetur të borgjit prej 456.18 €, me kamatë ligjore prej 8%, nga dita e paraqitjes së padisë në gjykatë e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e kësaj procedure në shumë prej 20 €, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit me forcë.
- II. OBLIGOHET** paditësja të paguaj taksën gjyqësore për padi, në shumë prej 20 €, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të kopjes së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit me forcë.

Arsyetimi

Paditësja ka ushtruar padi kundër të paditurit me datën 26.09.2017, me pretendimin se me datë 24.09.2013 i padituri ka marrë kredi nga paditësja në shumë prej 3,000.00 € por për shkak të mos kthimit me rregull të kredisë, i padituri ka mbetur borgj shumë prej 456.16 €.

Gjykata, të paditurit, me datë 26.12.2017, i'a ka dorëzuar padinë së bashku me provat e lëndës si dhe aktvendimin për përgjigje në padinë e paditëses, por i padituri, ndonëse i ka pranuar shkresat me rregull (provë: fletëkthesa e nënshkruar me datë 04.01.2018 nga gruaja e të paditurit [REDACTED] brenda afatit të caktuar ligjor, nuk ka ushtruar në këtë gjykatë përgjigjen e tij nëse e kundërshton apo jo kërkesëpadinë e paditëses, ndërsa gjykata nga provat e çështjes, ka gjetur se themelësia e kërkesëpadisë del nga faktet e treguara në padi dhe se faktet e tilla nuk janë në kundërshtim me provat e propozuara nga paditësja.

Andaj, Gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi bazur në nenin 150 të LPK-së, lidhur me nenin 136 par.1 dhe nenit 170 të LMD-së, ndërsa për kamatëvonesën në lartësi prej 8% Gjykata ka vendosur në bazë të nenit 382 par.2 i LMD-së.

Për shpenzimet e procedurës gjykata e ngarkoi me pagesë të paditurin në bazë të nenit 452 par.1 i LPK-së, ndërsa pagesën e taksës gjyqësore për padi, gjykata ia ngarkoi paditëses, në bazë të UA nr.1/2017 të KGJK-së për Unifikimin e Taksave Gjyqësore.

REPUBLIKA E KOSOVES
GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
C.nr.849/17, me datën 25.01.2018

VENDIMI ËSHTË I PLOTFUQISHËM
ODLUKA JE PRAVNOSNAŽNA
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD
FERIZAJ II UROŠEVAC

Më
Data 27.02.2018

KËSHILLI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh pas pranimit të tij, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.

